

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rritet me 14.3% kreditimi, rekord në pasuri të paluajtshme! Sejko-bankave: Vijoni financimin e ekonomisë, por me kujdes - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/rritet-me-143-kreditimi-rekord-ne-pasuri-te-paluajtshme-sejk-obankave-vijoni-financimin-e-ekonomise-por-me-kujdes
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 15:06:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 15:04:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fb6b46cae98418525432eab0719c50b375542c7351a29dbb5101014ac95dd371
TEKSTI	b938afd28ab21db79703f070ae25022d3aff63925ef383c7a301df89e6e0702b
PAMJA	a0e183d95b2fc132666b4e1feb3dba71cbeb0184ccf7c2a9009f2f56a77ec098

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a2a17604d1318dd0b406622d37552d4677fcd1a9a117aa7f4ae15ce670cdf018
E MËPARSHMJA	fece5b0d50a40c393cf37e985f44dd71f4f706f6cfdc4d68d9094e49d8f5790a
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a2a17604d1318dd0b406622d37552d4677fcd1a9a117aa7f4ae15ce670cdf018>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Nga Greqia në Lubalesh/ Pas 35 vitesh në emigrim, Çlirim Salku vendos të rikthehet në atdhe: Kam marrë vendimin e duhur!



Ekonomi

Rritet me 14.3% kreditimi, rekord në pasuri të paluajtshme! Sejko-bankave: Vijoni financimin e ekonomisë, por me kujdes

Gubernuratori Sejko u bëri thirrje bankave tregtare që të angazhohen më aktivisht në zbatimin e programit dhe të rrisin kreditimin e bizneseve përfituese nëpërmjet tij, duke shfrytëzuar fondet dhe kushtet e favorshme që ai ofron.



Banka e Shqipërisë



Redaksia

16 Shtator, 17:01 | Përditësimi: 16 Shtator, 17:04

f Share Tweet

A A

Gubernuratori i Bankës së Shqipërisë, [Gent Sejko](#), mbledhi këtë të mërkurë në një takim Ministrën e Ekonomisë Delina Ibrahimaj, me drejtorët e përgjithshëm të bankave tregtare që operojnë në Shqipëri.

Takimi u zhvillua në kuadër të dialogut të vazhdueshëm të Bankës së Shqipërisë me sektorin bankar dhe u përqendrua në zhvillimet më të fundit në veprimtarinë bankare, ecurinë e kreditimit, tregun e pasurive të paluajtshme, si dhe në çështje me rëndësi për stabilitetin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit financiar.

Vëmendje e veçantë gjatë diskutimeve iu kushtua ecurisë së kreditimit dhe rolit të sektorit bankar në financimin e ekonomisë. Të dhënat tregojnë se kreditimi vijon të ruajë ritme të larta rritjeje. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, kredia për sektorin privat u rrit me 14.3% në terma vjetorë, ndërsa raporti i saj ndaj PBB-së arriti në rreth 35%, niveli më i lartë i regjistruar në dekadën e fundit. Rritja e kreditimit ka qenë e pranishme si në segmentin e bizneseve, ashtu edhe në atë të individëve.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:

'Programi i Strehimit' përballë krizës së banesave, 7 mijë familje në pritje të mbështetjes, ekspertët: Me 60 mijë euro nuk gjen shtëpi në Tiranë

Gubernuratori Sejko vlerësoi se këto zhvillime krijojnë premisa që kreditimi të vijojë të mbështesë konsumin dhe investimet në [ekonomi](#). Në të njëjtën kohë, ai theksoi rëndësinë që rritja e kredisë të vijojë në mënyrë të kujdesshme dhe të shëndetshme, duke ruajtur standarde të përshtatshme kreditimi dhe administrimi të rrezikut.



Një tjetër çështje e diskutuar ishin edhe zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme dhe lidhja e tyre me aktivitetin kreditues. Diskutimet u fokusuan në ecurinë dhe dinamikën e këtij tregu, si dhe në zhvillimet e kreditimit për blerjen e banesave. Kredia hipotekare vijoi të shfaqë ritme të larta rritjeje, duke u zgjeruar me 16.1% në terma vjetorë gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2026. Ndërkohë, norma mesatare e interesit për kreditë hipotekare në lekë qëndroi në nivelin 3.9%.

Në këtë kuadër, Guvernatori Sejko u ndal edhe në masat makroprudenciale të ndërmarra nga [Banka e Shqipërisë](#) për financimin e blerjeve në tregun e pasurive të paluajtshme, përmes vendosjes së kufijve të sipërm për kredidhënien për pasuri të paluajtshme rezidenciale, bazuar në raportet "[kredi](#) ndaj vlerës së pronës" dhe "shërbimi i borxhit ndaj të ardhurave". Guvernatori vlerësoi se masat e marra kanë dhënë efektet e pritshme, duke kontribuar në një kreditim më të kujdesshëm dhe të balancuar të tregut të banesave. Ai theksoi se këto masa mbështesin zhvillimin e shëndetshëm të kreditimit dhe forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit bankar.

Në takim u diskutua gjithashtu ecuria e Programit të Financimit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm, të vënë në zbatim nga Banka e Shqipërisë për të përmirësuar aksesin në financim dhe për të ulur kostot e kredisë për këtë segment të rëndësishëm të ekonomisë. Nëpërmjet këtij programi, Banka e Shqipërisë ka vënë në dispozicion një fond prej 25 miliardë lekësh, i cili kanalizohet nëpërmjet bankave tregtare drejt bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe fermerëve. Programi krijon mundësi financimi me norma interesi të favorshme dhe është zgatur deri në fund të vitit 2027. Deri më tani, në kuadër të këtij programi, Banka e Shqipërisë ka injektuar rreth 2.2 miliardë lekë likuiditet në sistemin bankar për financimin e bizneseve përfutuese.

Guvernatori Sejko u bëri thirrje bankave tregtare që të angazhohen më aktivisht në zbatimin e programit dhe të rrisin kreditimin e bizneseve përfutuese nëpërmjet tij, duke shfrytëzuar fondet dhe kushtet e favorshme që ai ofron. Ai theksoi se një përdorim më i gjerë i këtij instrumenti do të ndihmojë në përmirësimin e aksesit të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme në financim, në mbështetjen e investimeve dhe në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese të ekonomisë.

Në vijim, pjesëmarrësit diskutuan edhe çështje të lidhura me takimet e fundit të Misionit të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) në Shqipëri. Në këtë kuadër, u shkëmbyen vlerësime mbi çështjet e trajtuara gjatë misionit dhe angazhimin e sektorit bankar në këtë proces.

Në përfundim, Guvernatori Sejko vlerësoi bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave tregtare, duke nënvizuar rëndësinë e dialogut të hapur dhe të koordinimit për adresimin në kohë të sfidave dhe për ruajtjen e një sistemi bankar të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm, në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit.

R.Xh/Shqiptarja.com

TAG: [ekonomi](#) [bizneset](#) [kredi](#) [gent sejko](#) [banka e Shqipërisë](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ 1.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës: Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë Të gabuar Nuk e di

Lajme të tjera



Zv/Ndihmës Sekretari amerikan i Shtetit: Po punojmë me Shqipërinë për të goditur organizatat kriminale transnacionale dhe për të zgjeruar qasjen e kompanive të SHBA në treg

15 Shtator, 16:27



Kredia e keqe ulet në përqindje por rritet në vlerë, Banka: Në balance janë 36.9 mld lekë borxh me probleme



Eliza Gjedik

14 Shtator, 16:31



Shoqatat kundër nismës së 'Dhomës Ekonomike Kombëtare': Biznesi duhet të jetë i lirë të zgjedhë ku anëtarësohet, po krijohet monopol

11 Shtator, 13:42



Sejko pret përfaqësuesen e UNDP-së, diskutojnë për ekonominë, ndryshimet klimatike dhe integrimin në BE

11 Shtator, 13:02



RAPORTI/ Turistët shpenzuan në Shqipëri 2.3 miliardë euro në gjysmën e parë të vitit!



Eliza Gjedik

10 Shtator, 18:53



'Blerja e tokave në Zvërnec' rriti investimet e huaja me 86%, BSH: Në 6 muaj të huajt investuan në Shqipëri 1.1 miliardë euro!



Eliza Gjedik

10 Shtator, 18:42



Rekord/ Emigrantët sollën 621 mln euro për të afërmit në gjysmën e parë të vitit! BSH: Vetëm në tremujorin e dytë rritje me 23%



Eliza Gjedik

10 Shtator, 16:36




Sejko takon drejtuesin e BERZH, diskutojnë kreditimin dhe integrimin financiar në BE

10 Shtator, 12:27



Të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara rriten me 30%, afro 2 milionë euro në 8 muaj

9 Shtator, 19:36



Fatos Çoçoli: Më në fund kontroll real i çmimeve?



Fatos Çoçoli

6 Shtator, 19:24



Sejko: Besueshmëria e bankave qendrore, thelbësore për stabilitetin ekonomik

5 Shtator, 17:40



Lorenc Vangjeli: Kur biznesi përdor armët, çfarë ndodh me ata që shkuan nga armët në biznes



Lorenc Vangjeli

4 Shtator, 20:09

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.